

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 7

Ekzklusiv: Arrestohet në Elbasan një i cili shfaqet si informator në vrasjen e COVID 4, më pas hapen spitalet rajonale (VIDEO)
- 2

Shehu në Repolitik: Nuk ka asnjë rast vetëvrasje nga spitalet COVID në Europë! Mjekja Kuli: Kemi gati
- 3

United State America: deti na përdet e shpesh, avionet e NATO-s përdoren më Tiranë! Report Tv: I gati pamje
- 4


Nga dreka në restorant në pritje me 13 plumbat si i zhpëtoi Durm Bani i predhëve të kalashtit që i shpuan Range-Roverin
- 5

Meta i dha nënshkrimin si VIP në 8 orë/ Dënohet me 100 orë punë Cobbina, për falsifikim të legjes së qendrimit të ken nga Tirana, firmos me një jetë e këq

Aktualitet

Një muaj më parë i ekzekutuan vëllanë/ Shpërthim në shtëpinë e Talo Çelës, në oborr u gjet 2.8 kg tritol i paplasur! I shumëkëkuari e kontrollon nga arratia me kamera (VIDEO)

Në orët e para të mëngjesit të sotëm i është vënë tritol shtëpisë së Talo Çelës të shumëkëkuarit nga Elbasani i cili ndodhet në kërkim për grabitjen e Rinasit dhe për atentatin me armë zjarri të 2 vëllezërve Haxhia në Durrës.



LEXO EDHE:
Sulmi me tritol në vilën e Talo Çelës si kundërpërgjigje e tritolit të vënë në banesën e mikut të Dumanit

Nga ana tjetër në zonën ku ndodhet shtëpia nuk ka banesa të tjera afër dhe as kamera të cilat mund të kenë filmuar autorin. Ndërkat mësohet se shtëpia ndodhet 150 metra larg vendit ku u ekzekutua vëllai i Talos, Bujar Çela.

"Më datë 05.11.2020, rreth orës 04:45, në fshatin Katundi i Ri, Elbasan, në pjesën e jashtme të banesës e cila është e pabanueshme në pronësi shtetasi T.Ç., 49 vjeç, ka shpërthyer një sasi dyshohet lëndë plasëse, ku si pasojë ka vetëm dëme materiale. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar forcat e Policisë dhe grupi hetimor ka vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit", thotë policia.

Ndërkaq kujtojmë se ka kaluar më shumë se një muaj, nga vrasja e Bujar Çelës, vëllait të Talo Çelës, e ndodhur rreth orës 05:45 të mëngjesit të 17 shtatorit, atëherë kur 62-vjeçari konsumonte kafënë e mëngjesit, për shkak se punonte taksist ku pristë udhëtarë që vinin me autobusë nga Greqia. Makina e tij tip "Benz" me targa AA 020 UZ, që e përdorte si taksit ishte parkuar në hyrje të lokalit në Bradashesh, ku Cela po konsumonte kafënë në momentin që është ekzekutuar. Pista kryesore e hetimeve për vrasjen e Bujar Çelës është për shkak të përfshirjes kriminale të vëllait të tij, Talo Çela.

Çela është autori i dyshuar i ngjarjes së datës 9 prill 2019, ndodhur në pistën e aeroportit "Nënë Tereza", në Rinas, Tiranë, ku persona të maskuar, nën kërcënimin e armëve të zjarrit, kanë arritur të vjedhin një sasi të konsiderueshme vlerash monetare të cilat po ngarkoheshin në avion dhe më pas gjatë shkëmbimit të zjarrit me Policinë, mbeti i vrarë njëri prej autorëve kryesorë të kësaj ngjarjeje.

Gjithashtu ai dyshohet se fshihet pas atentatit me armë zjarri të 2 vëllezërve Haxhia në Durrës. Emri i Talo Çelës ka dalë në dritë përmes dëshmisë së të penduarit të drejtësisë, Klevis Alla, të arrestuar për vrasjen e vëllezërve Haxhia.



Talo Çela dhe vëllai i tij Bujar Çela i ekzekutuar një muaj më parë



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 16:20
Autoret tentuan të rrëzonin shtëpinë, por iu dështoi plani, në oborrin e Talo Çelës u gjetën 2.8 kg tritol i paplasur

Detaje të reja kanë dalë nga shpërthimi me tritol në orët e para të mëngjesit në shtëpinë e Talo Çelës, ku burime për Report Tv kanë mundur të mësojnë se në oborr është gjetur rreth 2.8 kg lëndë plasëse e pashpërthyer.

Ende nuk dihen shkaqet se pse lëndë plasëse nuk ka shpërthyer e gjitha, por nëse ajo do të kishte plasur shtëpia e të shumëkëkuarit mund të ishte shembur.



Ora 07:57
I vunë eksploziv në mëngjes/ Në shtëpinë e Talo Çelës ka kamera sigurie, i kontrollon vetëm ai nga arratia (FOTO)



Në shtëpinë e të shumëkëkuarit nga Elbasani ku ndodhi shpërthimi me tritol ka kamera sigurie, të cilat sipas burimeve të Report Tv i kontrollon vetëm Talo Çela i cili është në arrati.

Kjo pasi edhe në shtëpi nuk banon asnjëri.



Ora 07:36
Shpërthimi me tritol/ Në shtëpinë e Talo Çelës s'banonte njeri, në zonë s'ka kamera sigurie! Banesa 150 metra larg vendit ku iu ekzekutua i vëllai



Në shtëpinë e Talo Çelës ku iu vrit tritol sot në orët e para të mëngjesit nuk banonte asnjëri.

Në zonën ku ndodhet shtëpia nuk ka banesa të tjera dhe as kamera të cilat mund të kenë filmuar autorin, kështu që do ta gjendë më të vështirë të gjendet se kush fshihet pas ngjarjes.

Ndërkaq gazetari i Report Tv mëson se shtëpia ndodhet shumë pranë me vendin ku është ekzekutuar vëllai i tij Talos,Bujar Çela. Shtëpia ndodhet 150 metra larg vendit ku iu ekzekutua i vëllai.




Ora 07:35
I vunë tritol, dëme të mëdha materiale në katin e parë të shtëpisë së Talo Çelës, xhamat bëhen copë (VIDEO)



Këto janë pamjet që tregojnë dëmet e shkaktuara në banesën e Talo Çelës të cilin i kanë vënë tritol në orët e para të mëngjesit.

Në shtëpi vihet re se ka dëme materiale në katin e parë të shtëpisë së tij. Xhamat e ndërtesës në të cilën nuk banonte njeri janë bërë copë.



Ora 07:20
I vunë tritol gjatë natës, kjo është shtëpia e Talo Çelës



Kjo është shtëpia e Talo Çelës të cilin i kanë vënë tritol gjatë natës, ndërkohë që ai është ende në arrati për grabitjen në Rinas dhe i dyshuar për vrasjen e vëllezërve Haxhia në Durrës.



Be.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: tritol shqiptarja.com Bujar Çela talo çela

Ndalohet repretisist riplubikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e konsideroni situatën në spitalet COVID?

Shqetësuese Normale Nuk e di

Komento

Komente

Iris: 06/11/2020 01:40
/NEST/Ne asnjë vend demokratik,gazetaret nuk dytohen ne prokurori.Gazetari te drejte ligjore jo vetem te konfirmime dhe informacionit,por dhe veten e tij,por duhet qe info,te jete e sakte,e vertete,e besueshme,e kufizueshme dhe si gazetari ashtu dhe burimi i info, te qendroje pas info,qe publikojne,shembulli me klasik i qendrimit te shtetit ndaj gaztareve,eshte publikimi i skandalit te Nixonit dhe investigimi i tij nga Washington Post.

Përgjigju

BENI: 05/11/2020 18:04
E realizojne heren fjeten,,biles te shemben edhe shtepite mbrrapa,,nuk zihet zoka e bukes per shtepi,,shtepite te behen ne kodra....

Përgjigju

Nesti: 05/11/2020 09:44
Po kto jane budalligje kot presjone adoleshenteshe, por eshte e cuditshme se si ky person ne kerkim, del e jep interviste nji gazetari investigativ???!! Po tkishim pas prokurore qe bojne punen per tullen paguhen, ate gazetarin, me gjithë respektin qe kam, duhet ta dergonin per ndjekje penale

Përgjigju

Roni: 05/11/2020 14:42
Ku ka prokurori o Zoti !!! Ata bashk me gjyqtaret jan Band me vete dhe shume strukturas kriminale !!! Ata korruptohen e bojne pazare pa i hrr gjemb ne kemb . Jan me te rezikshem se ky ...

Turi: 05/11/2020 08:50
Cte mbjellesh do korresh

Përgjigju

Vlora: 05/11/2020 08:01
Nuk esht burmi kjo gje .-pun frikacakesh

Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet COVID-19, kalimtet e reja Mjekja Kuli: Spitali COVID 4 është gati, më pas hapen spitalet në rrethe (VIDEO) 10 Nëntor, 22:39

Aktualitet Koduzi: Vetëm testimi dhe gjurmimi ul numrin e rasteve, jo masat kufizuese! Mjekja Kuli: Qytetarët nuk i respektojnë ndaj rriten të infektuarit (VIDEO) 10 Nëntor, 22:09

Aktualitet Shehu në Repolitik: Nuk ka asnjë rast vetëvrasje nga spitalet COVID në Europë! Mjekja Kuli: Kemi gati COVID 4, më pas hapen spitalet rajonale (VIDEO) 10 Nëntor, 21:42

Aktualitet Burgu i të moshuarve në Pogradec për 110 të dënuar, Gjonaj: Do përfundojë në shtator 2021 (VIDEO) 10 Nëntor, 21:30

Aktualitet Masat anti-COVID, qytetarët në Tiranë mirëpresin kufizimet: Të domosdoshme në këtë situatë, njerëzit po vdesin çdo ditë (VIDEO) Diamirë Leka 10 Nëntor, 19:57